

Shkolla në komunitetin Wallonie-Bruxelles në Belgjikë

Udhëzues informacionesh

destinuar familjeve të emigrantëve

ALBANAIS (SHQIP)



A Belgian Red Cross and European Refugee Fund project
Reviewed and edited by the Head Office of Compulsory Education
Translated into the following languages:
English, Russian, Arabic, Farsi, Pashto, Albanian and Serbo-Croatian.



F.E.R.

Fonds Européen pour les Réfugiés

This booklet was published with financial assistance from the European Union. The content of this document is the sole responsibility of the French-speaking Belgian Red Cross and may in no circumstances be considered to reflect the position of the European Union.






Document developed in conjunction with the
Wallonia-Brussels Federation

CROIX-ROUGE
de Belgique



www.croix-rouge.be





Koordinimi :

Madeleine Kirsch

Këshilltare për formacionin në Departamentin e Pritjes së kërkuësve të azilit në Kryqin e Kuq të Belgjikës

Realizimi :

Emilien Clonan

Grafizmi, formati, shtypja :

Shtëpia e Grafizmit, Verviers

Illustrations:

The director, pedagogical team and students of the city of Namur Technical School Félicien Rops for the illustration work (as well as Mister Paris' contribution at ITCF Henri Maus)

Graphics, layout, printing:

La Maison du Graphisme, Verviers

Special thanks to:

Billy Jüngling

Drejtor i Departamentit të Pritjes së kërkuësve të azilit në Kryqin e Kuq të Belgjikës

Pjestarët e personelit të Kryqit të Kuq, mësuesit dhe drejtoritë e shkollave (profesionistë të arsimit, inspektorë) dhe Henryk Chojnacki (qendra Fédasil në Rixensart) që kanë përcaktuar përmbajtjen e kësaj broshure.

Drejtorinë, ekipin pedagogjik si dhe nxënësit e Institutit Teknik Félicien Rops të qytetit të Namurit për punën e tyre për ilustrimin (pa harruar ndihmën e Z. Paris të ITCF Henri Maus).

France Martin për punën e tij për ilustrimin.

Komunitetin Francez

Të gjithë personat që e kanë rilexuar ose që kanë hedhur një shikim mbi këtë punë.

.....

The Belgian Red Cross reserves the rights to use or duplicate the contents of this booklet

Botues përgjegjës: D. Sondag-Thull, rue de Stalle 96, B-1180 Bruxelles.

© Belgian Red Cross – Reprinted 2017

The Belgian Red Cross needs your support in all its actions (national and international emergency relief, support to asylum seekers, local social action, blood donation, etc).

Contact us if you wish to help us help people in need.

www.croix-rouge.be

Thank you.

Zonjë, Zotëri,

ju urojmë mirëseardhjen.

Prej më shumë se njëzet e pesë vjetësh, Kryqi i Kuq i Belgjikës pret kërkuesit e azilit. Një nga misionet tona është të mbështesim familjet në shkollimin e fëmijëve të tyre.

Gjatë këtyre viteve, ne kemi konstatuar që shumë prindër që kemi pritur e njohin keq shkollën në Belgjikë. Shume shpesh, vetë organizimi i saj dhe mosnjohja e gjuhës përbëjnë një pengesë për prindërit që dëshirojnë të përfshihen në shkollimin e fëmijëve të tyre.

Me qëllim që t'ju shoqërojmë në zbulimin e shkollës në Belgjikë, kemi krijuar këtë broshurë informacioni me ndihmën e Fondit Europian për Refugjatët dhe të Federacioni Wallonie-Bruxelles.

Mësues, punonjës të qendrave Psiko-Mediko Sociale, profesionistë të shoqërimit të emigrantëve dhe të arsimit, Shoqata dhe prindër kanë ndihmuar në krijimin e saj.

Në Belgjikë, fëmijët mund të shkojnë në shkollë nisur nga mosha 2 vjeç e gjysëm. Për moshën 6 deri në 18 vjeç, shkolla është e detyrueshme.

Ju do të gjeni në këtë broshurë informacione mbi atë **çfarë shkolla mund t'j shtell fëmijës tuaj**, mbi **të drejtat dhe detyrat tuaja dhe të qendrave shkollore**, një përshkrim të **organizimit të shkollës edhe DASPA's** si edhe **informacione të ndryshme praktike**.

Për dijeni, çdo fjalë e shkruar me ngjyrë **rozë** në këtë broshurë është shpjeguar në leksikon, fjalorin që do ta gjeni në fund të dokumentit.

Lexim të këndshëm !

Billy JÜNGLING

Drjetor i Departementit të
Pritjes së Kërkuesve të Azilit
Kryqi i Kuq Belgjikë

Përmbledhje

Fjala e mirëseardhjes 5

Çfarë mund t'i sjellë shkolla fëmijës tim ?..... f.

Të mësojë të flasë, të lexojë dhe të shkruajë..... f.

Të marrë diploma dhe të gjejë më lehtësisht një punë f.

Të mësojë të njohë Belgjikën dhe të favorizojë integrimin f.

Cilat janë të drejtat dhe detyrat tona si prindër ?

Dhe cilat janë ato të shkollës?..... f.

Si është organizuar shkolla në Belgjikë ? f.

Tre komunitete..... f.

Sistemi zyrtar dhe sistemi i lirë f.

Shkolla në Belgjikë është ndarë në tre nivele f.

Kopështi ose niveli parashkollor

Shkolla fillore

Shkolla e mesme

Arsimi i specializuar f.

Çfarë janë DASPA-të ? Mundet të shkojë fëmija im në DASPA ?..... f.

Kush punon në shkollat e Belgjikës ? f.

Informacione praktike f.

Si ta regjistroj fëmijën tim ? f.

Si zhvillohet një vit shkollor ? f.

Si zhvillohet një javë në shkollë ? Po një ditë ? f.

Cilat janë rregullat që duhen respektuar në klasë?..... f.

Si zhvillohen kurset e sportit? f.

Çfarë është ditari i klasës ?..... f.

Çfarë është një Qendër Psiko-Mediko Sociale ?..... f.

Çfarë bëjnë mediatorët shkollorë ?..... f.

Kujt t'i drejtohem po të jetë fëmija im në vështirësi shkollore? f.

Çfarë duhet të bëjë në rast transferimi të familjes ?..... f.

Ku mundem të gjej informacione të tjera ? f.

Leksiku dhe fjalori i diplomave f

Çfarë mund t'i sjellë shkolla fëmijës tim ?

Çfarë mund t'i sjellë shkolla fëmijës tim ?

Të shkuarit në shkollë i jep fëmijës tim mundësinë të mësojë flasë, të lexojë dhe të shkruajë :

Shoqëria Belge është bazuar mbi të shkruarin. Në komunitetin frankofon të Belgjikës, çdo ditë, është e rëndësishme të dish të flasësh, të kuptosh, të lexosh dhe të shkruash frëngjisht.

Që fëmija im të ndjekë kurse, të bëjë miq, të marrë trenin, të shkojë te tregtarët, të plotësojë dokumenta administrative, të shkruajë letra, etj..., është e domosdoshme të zotërojë frëngjishten.

Të dish të lexosh, të flasësh, të dëgjosh dhe të shkruash frëngjisht të lejon gjithashtu të gjesh më lehtë një punë. Duhet njëfarë kohe që fëmija juaj të mësojë dhe të zotërojë frëngjishten.


Të shkuarit në shkollë e ndihmon fëmijën tim të marrë një diplomë, të zhvillojë një numër aftësish dhe të gjejë më lehtë punë :

Ne Belgjikë, është e rëndësishme të kesh një formim për të gjetur një punë. Një **diplomë** është një dokument që provon që fëmija im ka ndjekur studime dhe që ai zotëron dije dhe aftësi praktike. Këto diploma merren në shkollë. Gjithçka që fëmija im mund të mësojë në shkollë do të jetë një përfitim për të, çfarëdo qoftë e ardhmja e tij.



Të shkuarit në shkollë e ndihmon fëmijën tim të mësojë të njohë vendin në të cilin ai jeton :

Shkolla i lejon fëmijës tim të njohë vlerat e Belgjikës. Për shembull, fëmija im do të mësojë në shkollë që Belgjika mbron idenë që Njërëzit lindin të lirë dhe me të drejta dhe detyra të barabarta, çfarë do që të jetë orgjinia e tyre sociale, gjeografike, seksi ose feja e tyre. Shkolla i ofron fëmijës tim të takojë popullsinë që jeton në Belgjikë, të mësojë rregullat e jetës të shoqërisë belge dhe kështu të favorizojë integrimin e tij.



Cilat janë të drejtat dhe detyrat tona si prindër ? Dhe cilat janë ato të shkollës ?

.....

Në Belgjikë, të gjithë fëmijët e moshës midis 6 dhe 18 vjeç kanë për detyrë të shkojnë në shkollë, cilado qoftë nënshtetësia ose statusi i tyre. Vajzat dhe djemtë shkojnë në të njetat shkolla dhe ndjekin kurset së bashku.



Pse shkolla është e detyruar ?

Ne Belgjikë, puna e fëmijëve është e ndaluar. Duke e bërë shkollën të detyruar, Belgjika kërkon që të gjithë fëmijët të kenë të njëjtat shanse të mësojnë dhe më vonë të gjejnë një punë. Ligji belg i 29 qërshorit 1983 mbi detyrimin shkollorë. Në qoftë se ky ligj nuk është respektuar, ekzistojnë dënime.

Artikulli 1 : §1 : I mituri i nënshtrohet detyrimit shkollor gjatë një periudhe prej 12 vjetësh që fillojnë me vitin shkollor kur ai mbush gjashtë vjeç dhe mbaron në fund të vitit shkollor gjatë të cilit ai arrin moshën 18 vjeç.

Ligji mbi detyrimin shkollor.
1983

Detyrat dhe të drejtat e prindërve.

Detyrat e prindërve

Si prind që jam, unë duhet të bëj kujdes që fëmija im të shkojë çdo ditë në shkollë. Në qoftë se fëmija im nuk mundet të shkojë në shkollë, roli im është të lajmëroj shkollën ditën kur ai mungon. Duhet pastaj të **justifikoj mungesën e tij** duke respektuar periudhat e specifikuar nga rregullorja. Për shëmbull, në qoftë se fëmija im është sëmurë, duhet t'i jepet shkollës një certifikatë e miekut.



Duhet gjithashtu të sigurohem që fëmija im i bën **ushtrimet** e kerkuara nga profesori dhe që studion mësimet e tija. Në qoftë se unë nuk zotëroj frëngjishten, është e rëndësishme t'i kërkoj fëmijës tim se çfarë bën dhe a e kupton atë që po bën. Kjo më lejon mua, si dhe profesorëve, të shikojmë progresin e fëmijës tim.




Duhet gjithashtu të njoh informacionet që më janë transmetuar nga shkolla. Disa prej tyre janë shumë të rëndësishme. Këto informacione më janë dërguar me postë ose me **ditarin e klasës**. (shih faqen ...)

Në çdo shkollë, ligji parashikon ngritjen e një këshilli pjesëmarrës. Qellimi e këtij Keshilli është të bashkoj punojtë të ndryshëm (arsimëtar, edukator, etj..) edhe perfaqësuesat prindërisht dhe xënës për të folur mbi kualitetin e jetës në shkollë.

Gjatë orëve të kursit, nuk mund të hyj në klasë. Në qoftë se dëshiroj të takoj një mësues, mundem t'i kërkoj një takim.

Të drejtat e prindërve.

Kam të drejtë t'i kërkoj një takim mësuesve edhe/ose Drejtorit të Shkollës.



Në qoftë se unë kam vështirësi me fëmijën tim, kam të drejtë të kërkoj ndihmën e një Qendre Psiko-Mediko-Sociale gjatë gjithë shkollimit të tij (shih faqen ...)

Kam të drejtë të marrë pjesë në një **shoqatë prindërisht**. Shoqatat e prindërve bëjnë lidhjen midis shkollës dhe prindërve të nxënësve. Ata transmetojnë informacione, marrin pjesë në debatin rreth temave të rëndësishme të lidhur me shkollën...



Detyrat dhe të drejtat e nxënësve

Detyrat e nxënësve.

Çdo shkollë ka një rregullore të quajtur **Rregullorja e Rregullit të Brëndshëm (fr. ROI)**. Objektivi i kësaj rregulloreje është të fiksojë disa rregulla me qëllim që jeta në shkollë të jetë në harmoni.



Të gjithë nxënësit dhe prindërit kanë për detyrë të njohin dhe të respektojnë këtë rregullore.

Shpesh, kjo rregullore thotë që :

- nxënësit duhen të respektojnë të rriturit e shkollës, ashtu si edhe shokët e tyre (djemtë dhe vajzat).
- asnjë dhunë (gojore ose fizike) nuk tolerohet.
- sharjet, fjalët raciste janë të ndaluara.
- lokalet e shkollës dhe materiali i vënë në dispozicion kushtojnë shtrenjtë. Nxënësit duhet githashtu t'i respektojnë. Në qoftë se fëmija im thyen ose dëmton materialin ose lokalet, do të më kërkohet të paguaj dëmin.
- nxënësit duhet të bëjnë punën e kërkuar nga mësuesit.



Të drejtat e nxënësve.

Ata mund të kërkojnë të takojnë mësuesit.

Ata mund të kërkojnë të kenë shpjegime plotësuese nga ana e mësuesve.



Ata kanë githashtu të drejtën të studiojnë në qetësi, në lokalet përkatës.

Ata kanë të drejtën të shprehen në limitin e respektit për të tjerët (shokët dhe personelin i shkollës).

Detyrat dhe të drejtat e mësuesëve dhe të Shkollës.

Të drejtat
dhe detyrat
e çdonjërit

Mësuesit duhet :

Të respektohen dhe të ushtrojnë autoritetin e tyre duke respektuar integritetin fizik dhe moral të nxënësve.



T'i kushtojnë kohën e duhur për t'u dhënë shpjegime nxënësve.

Mësuesit kanë të drejtë :



Të kërkojnë respekt nga nxënësit.
T'i kërkojnë nxënësve të bëjnë **detyrat** (përfshirë edhe gjatë pushimeve shkollore).
Të dënojnë nxënësit në qoftë se është e justifikuar.
Të kërkojnë të takohen me prindërit



Shkollat duhet :

Të marrin në ngarkim të gjithë nxënësit brenda limitit të kapacitetit të pritjes.

Të hartojë një projekt shkollorë të cili të perditësohet çdo 3 vjet.

Të sinjalizojnë nxënësit që kanë kaluar numrin e ditëve me mungesa të pajustificuara. Mungesat e nxënësve janë llogaritur në gjysma ditësh. Në qoftë se fëmija im mungon një ditë, kjo i korrespondon dy gjysma ditësh

Në **arësimin fillor**, në qoftë se mungesat e fëmijës tim kalojnë **9 gjysma ditësh**, Drejtorja e shkollës duhet të lajmërojë Drejtorinë e Përgjithshme të Arësimit të Detyruar.

Në **arësimin e mesëm**, në qoftë se mungesat e pajustificuara të fëmijës tim kalojnë **10 gjysma ditësh**, shefi i shkollës duhet të vëjë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Arësimit të Detyruar.



Në qoftë se fëmija im ka braktisur shkollën, mund kërkoj ndihmë tek shërbimet të ndryshme për të gjetur zgjidhje, si CPMS, ose shërbime ndërmjetëse shkollorë nëse nxënësi është në shkollën e mesme.

Shkollat kanë të drejtë :

Të vendosin një sanksion për një nxënësit që nuk respekton rregullat shkollore.

Këto sanksione figurojnë në Rregulloren e Rregullit të Mbrëndshme



Si është organizuar Shkolla në Belgjikë ?

3 Komunitete

Në Belgjikë, ka tre komunitete dhe **tre gjuhë**

- Është Komuniteti Francez ose Federacioni Wallonie-Bruxelles (flitet frëngjisht),
- Komuniteti Gjermanfolës (flitet gjermanisht),
- Komuniteti Flamand (flitet flamisht)

Ne do t'ju prezantojmë këtu shkollën si ekziston në **Federacionin Wallonie-Bruxelles**.

Arsimi zyrtarë dhe arsimi i lirë.


Në Belgjikë, zgjedhja e shkollës është e lirë për prindërit. Kujtojmë megjithatë që shkollat nuk mund të pranojnë nxënës më shumë se kapaciteti i tyre i pritjes.

Ka dy tipe arsimesh. Arsimi që quhet "**arsimi zyrtarë**" dhe arsimi që quhet "**arsimi i lirë**".

Arsimi zyrtarë varet direkt nga pushteti publik, ose direkt nga Komuniteti Francez ose nga kumuna apo provinca. Ajë arsim nuk është lidhur më asnjë besim ose filozofi të veçantë por ofronë një zgjedhje midis kurseve të bësimeve të ndryshëm (katolike, protes-

tante, izraelite, myslimane dhe ortodokse) ose **kurse morali** (nxënësit mësojnë të drejtat dhe detyrat qytetare, bazat e demokracisë, të lirisë, të komunikimit, të shpirtit kritik, ...). Që në shtator 2015, një mbështetje alternative arsimore (EPA) organizohet për xënësit që nuk kanë zgjedh asnjë curz filozofik që i propozohën. Një kurz shtetesia do përgjithësohet nga viti 2017

Arsimi i lirë përmbanë shkollat e lira organizuar nga Dioceset, kongregacione fetare edhe shkolla të lira jo-fetare t'organizuar nga shoqatat me orientim pedagogjik te vecantë



Shkolla në Belgjikë është ndarë në 3 nivele

Kopështi ose niveli parashkollor : për fëmijët midis 2 ½ vjeç dhe 5 vjeç

Shkolla fillore : për fëmijët midis 6 vjeç dhe 11 vjeç

Shkolla e mësme : për fëmijët midis 12 vjeç dhe 18 vjeç

Për çdo nivel, ka objektiva të të mësuarit për të arritur.

Vajzat dhe djemtë shkojnë në të njejtat shkolla dhe ndjekin kurset së bashku.

Në kopësht, fëmija im do zbulojë shkollën (midis 2 ½ dhe 5 vjeç)

Ai do mësojë të jetojë në komunitet, dhe të zbulojë pak nga pak leximin, shkrimin dhe llogaritjet nëpërmjet lojës. Është një klasë që nuk është e detyruar por që e përgatit fëmijen tim për shkollën dhe që i lejon të mësojë frëngjishten.

Nisur nga shkolla fillore, shkolla është e detyruar (midis 6 dhe 11 vjeç).

Në shkollën fillore, fëmija im mëson të lexojë, të shkruajë dhe të llogarisë duke mësuar lëndë të tjera (shkenca, gjuhë, histoire, gjeografi...).

Në shtëpi, ai do të ketë **detyra** për të bërë mësim për të mësuar.

Në fund të fillorës, në klasën e 6-të, ai do të kalojë Çertifikatën e Studimeve të Bazes (fr. CEB). Është një provim i rëndësishëm që i jep një **diplomë**. Në qoftë se fëmija im e kalon, ai do të vazhdojë në vitin e parë të së mesmes. Në qoftë se nuk e kalon, ai mund të rifillojë vitin ose të shkojë në vit të parë të diferencuar. Në qoftë se ai kalon në të mesmen, ndodh shpesh që ai të lëjë shkollën e tij për të vazhduar tek një tjetër.



How is education organized in Belgium?

Në të mesmen, shkolla është githashtu e detyruar. Disa drejtime ekzistojnë (midis 12 dhe 18 vjeç).

Që në hyrjen në vit të parë, fëmija im do të jetë i regjistruar në një klasë që i korrespondon kapaciteteve të tij ne perputhje me kërkesat e pranimi (viti i parë i përbashkët ose viti i parë i diferencuar).

Nisur nga viti i tretë, disa orientime janë të mundshme për fëmijën tim :

- Të mësojë një zanat në seksionet e kualifikimit.
- Të studiojë që të vazhdojë studimet e larta ne seksionet e tranzicionit.

Te gjithë studentët që posedojnë certifikaten të arsimi të mesëm pavarësisht formës ose seksionit, mund të vazhdojnë në ciclin e parë të arsimit të lartë përveç në fushen shkencare inxhinjerike që kërkon marrjen e një certifikate pas një provimit të veçantë pranues.

Nisur nga 15 vjeç, fëmija im mund të ndjekë një formacion më praktik që ndahet midis shkollës dhe një ndërmarrje.

Për çdo pyetje lidhur me orientimin shkollor të fëmijës tim, mund t'i kërkoj ndihmë shkollës si dhe qendrës Psiko-Mediko-Sociale e lidhur me këtë shkollë.

Në Belgjikë ekziston një arsim i specializuar për fëmijët dhe adoleshentët që kanë nevojë për një shoqërim më të veçantë.

- Arsimi i specializuar është një arsim i adaptuar për nxënësit që kanë disa vështirësi (turbullime të sjelljes, handikape, mangësi...)
- Është Qendra Psiko-Mediko-Sociale (fr.PMS) që propozon një orientim drejt këtij tipi arsimit.
- Qendrat PMS kanë për mision të ndihmojnë fëmijët, adoleshentët si edhe prindërit. Ata vënë në dispozicion mjete për të ndihmuar nxënësit të përparojnë dhe për të mbështetur ato në arsim dhe në jetën e tyre
- Unë mund të kërkoj një takim në Qendrën PMS që punon me shkollën e fëmijës tim. Është falas.

Më shumë informacione mbi arësimin e specializuar në këtë sitë :

<http://www.enseignement.be/gen/syst.spec.pdf>



Çfarë është **DASPA** :

dispozitiv për pritjen dhe shkollimin et xënësve sapo ardhur ?

Disa shkolla presin një numër të madhë xënësish me origjinë të vëndeve të huaja dhe janë pa bagazhë dhe njohuri gjuhës frënge, në një sistem edukativ që nuk njohin. Këto xënësë kanë nevojë për perkrashje për të siguruar , si xënësve tjer një emancipim nga edukata. Xënësit sapo ardhur priten në DASPA gjatë një periudhë prej një jave deri 12 muaj, me një maksimum 18 muajsh. Gjatë kësaj kohe, ato përfitojnë një mbështetje që i ndihmon të adaptohen dhe të integrohen në sistemin kulturo-shoqëror dhe shkollorë belg. Pastaj drejtohen në arsimin që i përshtatet Kur mësuesit gjykojnë që fëmija mundet të shkojë në një klasë « të zakonshme», mblidhet **këshilli i integritetit**. Ai merr vendim, në funksion të nivelit të nxënësit, ta integrojë në një klasë që i korrespondon kapaciteteve të tija. Një vërtetim pranimi që ka vlerën e **diplomes**, i jepet atëhere nxënësit. Kështu nxënësi e lë DASPA-në.

Ju mund të gjeni një listë me shkollat që kanë një **klasë-kalimtare** në këtë sitë : <http://www.enseignement.be/> pastaj « l'école de A à Z », pastaj « passerelles », pastaj « **classes passerelles** ».


Që të mund të shkosh në një **DASPA** dispozitiv për pritjen dhe shkollimin e xënësve sapo ardhur


Ligji thote : çdo xenese qe ka arritur ne teritorin shteteror më pak se një vit dhe i moshuar 2vjec e gjysme deri 18 dhe ploteson kriteret e mëposhme :


- ose të jetë kërkuar azili, ose të jetë njohur si refugjat, ose të shoqërojë një person që ka bërë një kërkesë azili apo të jetë njohur si refugjat.
- ose të ketë kërkuar statusin e apatridëve (pa atdhe) ose të jetë njohur si apatrid, ose të jetë i ardhur nga një shtet në zhvillim ose nga një shtet i quajtur në tranzicion.

Lista është bërë nga Komiteti i ndihmës për zhvillim. Ju mund të gjeni këtë listë ne sitin e **OCDE**.

Për nxënësit që kanë marrë një **diplomë** në vendin e tyre të origjinës, është e mundur të kërkohej një ekuivalencë tek serviset e ekuivalencës në Komunitetin Francez. <http://www.enseignement.be/> pastaj « l'école de A à Z », pastaj « équivalences ».







Kush punon në shkollat e Belgjikës ?

Në kopësht dhe në shkollën fillore.


Ka një shef shkolle. Ai quhet Drejtor (ose Drejtoreshë). Ai (ose ajo) qeveris shkollën dhe organizon funksionimin e saj. Është përgjegjës (përgjegjëse) për shkollën.

Janë mësuesit. Këta janë gra dhe burra që kanë ndjekur një formacion dhe kanë një **diplomë** zyrtare. Në kopësht dhe në shkollën fillore, ata japin mësim disa lëndë. Ata vëzhgojnë githashtu dhe pushimet e

shkurtra, marrin pjesë në këshillat e klasës, takojnë prindërit në mbledhje prindërishe. Ata shoqërojnë fëmijët gjatë gjithë të mësuarit e tyre dhe i ndihmojnë të rriten.

Personeli punëtor pastron dhe mirëmban lokalet.

Në disa shkolla, roje të jashtëm ruajnë fëmijët në garderi në mëngjes dhe në mbrëmje. Ata mundën në disa raste të vëzhgojnë vaktin e drekës në mensë.



Në shkollën e mesme.

Shkollat janë më të mëdha. Nxënësit, personeli i shkollës atje janë më të shumtë.

Ka një shef shkolle. Ai quhet Prefekt (ose Prefekte) në **rrjetin zyrtar** (shih faqen) dhe Drejtor (ose Drejtoreshë) në **rrjetin e lirë** (shih faqen). Ai organizon shkollën. Është përgjegjës për shkollën.

Ka një Provizor në **rrjetin zyrtar** (shih faqen), që quhet Nëndrejtor (ose Nëndrejtoreshë) në **rrjetin e lirë** (shih faqen). Ai është ngarkuar me organizimin praktik në shkollë dhe mund të zvëndësojë Prefektin (ose Drejtorin) kur ai mungon.

Sekretariati i Drejtorisë qeveris personelin e shkollës.

Economisti është ngarkuar me kontabilitetin e

shkollës. Ai merret me financat. Ai organizon, për shembull, blerjet e materialit për mësuesit, shitjet e biletave për mensën, dhënien hua dhe shitjen e librave shkollorë.


Sekretariati i nxënësve dhe edukatorët survejues. Ata janë të ngarkuar të kontrollojnë hyrjet dhe daljet e nxënësve, pra të kontrollojnë mungesat. Ata survejojnë pushimet midis orëve, korridoret, mensën. Ata mund të merren me regjistrimin e nxënësve.

Mësuesit (ose profesorët) në shkollën e mesme janë gra dhe burra që japin mësim, në parim vetëm

një lëndë (Matematikë, frëngjisht, sport, ...). Ata kanë marrë një formacion dhe një **diplomë** në këtë lëndë. Pra nxënësit kanë shpesh aq mësues sa lëndë.

Ndodh që disa prej tyre japin megjithatë dy ose tre lëndë.

Në **DASPA**, disa shkolla kanë disa mësues por ndodh ndonjëherë që vetëm një mësues jep mësim. Personeli punëtor, nëse shkolla ka një të tillë, pastrojnë dhe mirëmban lokalet. Pastërtia e shkollës është megjithatë çështje e të gjithëve.




Si ta regjistroj fëmijën tim ?

Është e mundur të regjistroj fëmijën tim në çdo moment të vitit.



Që të regjistroj fëmijën tim, duhet të shkoj me të në shkollë. Personeli administrativ i shkollës do të ketë nevojë për disa dokumenta që të regjistrojë fëmijën tim. Është pra e rëndësishme të kem me vete letrat e identitetit (aneksin 26, karta portakalli, karta e identitetit..). Për një regjistrim në vit të parë të së mësmes, një formular do të më jetë dhënë



nga shkolla fillore. Duhet ta mbush këtë formular dhe t'ja jap shkollës së mesme që kam zgjedhur. Përgjigja do të më jepet më vonë.

Gjatë regjistrimit të fëmijës tim në shkollë, do të më japin **Regulloren e Urdhërit të Brendshëm (fr. ROI)**, projektin edukativ të shkollës, rregulloren e përgjithshme të studimeve dhe një listë me materialin e nevojshëm. Do të më jetë dhënë, gjithashtu, emri i qendrës **Psiko-Mediko-Sociale (PMS)** e lidhur me shkollën e fëmijës tim. Është rasti për mua të marr informacione dhe të vizitoj shkollën.

Mund të ndodhë që nga mungesa e vendit në shkollën e zgjedhur, unë nuk mund të regjistroj fëmijën tim. Kjo shkollë ka për detyrë të më japin një certifikatë që verteton kërkesën time për regjistrim. Duhet të kërkoj një shkollë tjetër për regjistrimin e fëmijës. Gjithashtu, mund të kontaktoj nepermjet një numër falas : 0800/ 188.55 Sherbimin i ndihmës për regjistrime te Komunitetit frances për të marr ndihmë në një gjetjen e një shkolle

Qasje te lirë në arsimin e detyruar.

Sipas Kushtetutës (Art 24) dhe dekretit (Missions) (Art 100 dhe pas) qasja në arsim është e lirë deri në fund të arsimit të detyrueshëm.

Në praktikë, përveç shkollave private, çdo shkollë është e financuar nga Federacioni Wallonie-Bruxelles. Shkolla fëmijës suaj në këtë mënyrë merr fonde për të siguruar arsim cilësor. Megjithatë financimi nuk mbulon tërësinë e kostove të lidhura me arsimin. Disa shpenzime nuk mund tju kerkohen. Shpenzime tjera të detyrueshem propozohen por ekzistojnë dhe shpenzime fakultative.

Para fillimit të vitit shkollorë, shkolla e fëmijës suaj ju transmeton një dokument që përmbanë vlerësimin e koston dhe mënyrën si ato janë të shpërdarë.

Në çdo kohë, nëse keni ndonjë vështirësi financiare që ju pengon pagesën e shpenzimeve, mos hezitoni për të folur me kryetarin e institucionit apo personit përgjegjës në këtë çështje në shkollë. Shpesh herë gjindët një zgjidhje të përshtatshme për secilin

Si zhvillohet një viti shkollor ?

Viti shkollor në Belgjikë fillon zakonisht në një shtator.

Në momente të ndryshëm të vitit ka pushime shkollore.

- Nga fund i tetorit dhe fillim e nëntorit : pushimet e vjeshtës të quajtura dhe pushime Toussaint (1 javë).
- Në fund të muajit dhjetor : pushimet e dimritë thirren pushimet e Krishtëlindjeve (2 javë).
- Gjatë muajit shkurt : pushime relaksuese thirren pushimet e Karnavalit (1 javë).
- Në fund të muajit mars dhe fillim të muajit prill : pushimet e pranverës quhen gjithashtu pushimet e Pashkëve, (2 javë).
- Viti mbaron në fund të qershorit. Nxënësit kanë atëherë dy muaj pushime.
- Ka githashtu dhe ditë pushimi zyrtare të njohura nga Belgjika. Janë ditë festash gjatë të cilave shkolla si dhe administrata dhe disa njësi tregtare janë të mbyllura.

Në arsimin Basë, shpeshtësinë dhe modalitetët të vlerësimit janë të shenuara në rregulloren e rregullit të mbrendshëm (ROI). Në parim, xënësit nënshtrohen në një vlerësim formativ gjatë gjithë vitit. Në fund të vitit 6, xënësi nënshtrohet një testi përmbledhës që quhet Certifikat të Arsiminit Bazë. Nëse provimi është i suksesshëm, xënësi kalon në arsimin e mesëm. Nëse jo, xënësi drejtohet në vit të parë diferencuar (shih skemen më poshtë).

Arsimi I mesëm : provimet bëhen zakonisht në dhjetor ose në janar si dhe në qershor. Pasi këto **provime** janë korrigjuar, shkolla fillon dhënien e dëftesave. Disa dëftesa të tjera janë dhënë gjatë vitit duke më dhënë mundësinë që të ndjek progresin e fëmijës tim.

Disa herë në vit, organizohen mbledhje midis mësuesve dhe prindërve. Mësuesit diskutojnë me mua mbi progresin e fëmijës tim, sjelljen e tij në klasë, etj. Unë mundem gjithashtu t'u bëj pyetje. Është shumë e rëndësishme që të shkoj në mbledhje çdo herë.

The school calendar is available on the following website: <http://www.enseignement.be>



Si zhvillohet një **javë** në shkollë ? Po një ditë ?

Java fillon të hënën në mëngjes dhe mbaron shumicën e kohës të premtën nga ora 16.00. Zakonisht, të mërkurën fëmijët kanë mësim vetëm paradite (ndonjëherë nxënësit e dënuar rrinë të mërkurën mbasdite). Gjithashtu, ekzistojnë ndonjëherë aktivitete jashtëshkollore që organizohen të mërkurën mbasdite.

Çdo shkollë vendos për orën e fillimit dhe të mbarimit të mësimi. Orari është i shënuar në rregulloren e rregullit të brendshëm

Çdo ditë, fëmijët kanë një pushim në mëngjes dhe një pushim për drekën midis kurseve të mëngjesit dhe atyre të mbasdites.


Në shkollën fillore :

Mësimi fillon në përgjithësi midis orës 8.00 dhe 9.00 për të mbaruar midis orës 15.30 dhe 16.00.

Në shkollë të mesme :

Çdo klasë ka një orar që e ka të vetin. Në fillim të vitit, mësuesit i japin nxënësve « orarin e mësimave ». Në të mesmen, është e mundur që mësimet mos të fillojnë dhe të mbarojnë çdo ditë në të njetat orë.

Në shkollën e mesme, nxënësit ndërrojnë mësues për çdo lëndë. Në përgjithësi, nxënësit ndërrojnë sallën e klases në çdo orë.



Cilat janë rregullat që duhen respektuar në klasë ?

Nxënësit duhet të arrijnë në orën e caktuar në klasë. Vonesat e pajustificuara mund të dënohen.



Në klasë, duhet të dëgjohet mësuesi. Për të marrë fjalën, duhet të ngrihet dora dhe të pritët që mësuesi ta ftojë fëmijën të flasë. Duhet gjithashtu respektuar fjala e tjetrit dhe nuk duhet që të ndërpritet.

Është e domosdoshme të kesh gjithë materialin (libra, fletore, stilolapsa, lapsa, vizore, lapsa me ngjyra...). Mësuesi mund të dënojë nxënësit që nuk kanë mjetet e tyre personale. Çdo shkollë dhe çdo mësues mund të kërkojnë një material specifik.



Cilat janë sanksionet në rastin e mosrespektimit të këtyre rregullave ?

Sanksionet varen nga thyerja e rregullave të kryera nga fëmija im. Unë do të jem lajmëruar me shkrim për çdo sanksion që i është dhënë fëmijës tim.



Një rikujtim i rregullit me punët që do të kryhen mund të jetë shkruajtur në **ditarin e klasës**.

Vërejtja do të thotë se fëmija im do të rrijë në shkollë një numër të caktuar orësh më shumë se orët e mësimit.

Përgjashtimi i përkohshëm nga mësimi do të thotë se fëmija im nuk mund të ndjekë mësimin në fjalë gjatë një numër të caktuar orësh.

Përgjashtimi i përkohshëm do të thotë se fëmija im nuk mund të ndjekë asnjë kurs gjatë një numër të caktuar ditësh.

Përgjashtimi përfundimtar do të thotë se fëmija im nuk është më i pranuar në gjirin e shkollës. Duhet gjetur një shkollë tjetër. Një procedure duhet të vendoset nga institucioni shkollorë para se të përgjashtohet fëmija im.

Si zhvillohen mësimet e edukatës fizike ?

Kurset e edukatës fizike janë të detyruar si gjithë kurset e tjerë.

Fëmija im duhet të ketë materialin : këpucë me thembër të bardhë, pantallona të shkurtra, bluzë me mëngë të shkurtra, (rroba banje dhe kapuç pishine si edhe një peshqir për aktivitetet e pishinës).




Çfarë është ditari i klasës ?

Është një fletore që i lejon fëmijës tim të shkruajë për çdo orë mësimi, lëndët mësuar, **detyrat** (ushtrimet dhe mësimet) që duhet të bëjë në shtëpi. Mund të jetë e tipit fletore shënimesh ose ditar.

Mësuesit më transmetojnë informacione ose vërejtje duke i shkruajtur në këtë **ditar klase**. Lejon gjithashtu komunikimin ndërmjet shkollës edhe familjeve

Fëmija im duhet të ketë gjithmonë me vete **ditarin e tij të klasës**.


Duhet të shikoj shumë rregullisht këtë fletore dhe ta firmos.



Cilët janë e çfarë bëjnë mediatorët shkollorë ?

Mediatorët shkollorë bëjnë pjesë tek një dispozitiv vendosur nga Federacioni Wallonie-Bruxelles në arsimin e mesëm. Ata ndërhyjnë me qëllim që të paralajmërojnë braktisjen dhe mungesat e nxënësve dhe dhunën në shkollë.

Drejtorët e shkollave, mësuesit, prindërit dhe nxënësit mund të kërkojnë ndihmën e mediatorëve shkollorë. Misionet e tyre është të lehtësojnë marrëdhëniet midis personave të ngarkuar me shkollimin e fëmijëve.



Kujt t'i drejtohem në qoftë se fëmija im ka vështirësi në shkollë ?

Disa shkolla propozojnë zgjidhje për t'u ardhur në ndihmë nxënësve në vështirësi. Unë mund të kërkojë të takoj mësuesit për të ditur çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar fëmijën tim.

Në qoftë se fëmija im ndesh vështirësi në të mësuarit, ekzistojnë shkolla të **detyrave** (fr. EDD). Këto shkolla gjenden jashtë territorit të shkollave dhe propozojnë aktivitete të ndryshme për t'i ardhur në ndihmë fëmijës tim. Disa mund të jenë me pagesë.

Lista e shkollave të **detyrave** si edhe hollësira për ndihmën që ato mund t'ju sjellin është e disponueshme në sitën : www.ffedd.be

Shërbimet e quajtura « accrochage » shkollor mund të ndihmojnë fëmijën tim një farë kohe në qoftë se ai është përjashtuar nga shkolla ose në qoftë se ai nuk shkon më në shkollë pa qënë i përjashtuar. Për më shumë informacione, vizitoni faqen e internetit e shërbimeve të miratuara të Asistencës Rinisë : www.aidealajeunesse.cfwb.be

Qendrat Psiko-Mediko-Sociale janë gjithashtu për të ndihmuar.

Çdo shkollë është lidhur me një qendër PMS. Ekipet e këtyre qendrave PMS janë të përbërë nga psikologë, punonjës socialë dhe mjekë ose infermierë(e).

Ata janë aty për të dëgjuar nxënësit dhe familjen e tyre dhe për të gjetur me ta zgjidhje për problemet e tyre (orientimin shkollor, vështirësi në mardhënie...). Ata kanë për mision të ndihmojnë fëmijet, adoleshentët si edhe prindërit e tyre. Ata vënë në veprim mjete për të ndihmuar nxënësit që të përgesojnë dhe për të shoqëruar në arsim dhe në jetën e tyre.

Qendrat PMS, gjithashtu, mund të japin mendimin e tyre për orientimin e nxënësve. Personeli i qendrave PMS ruan sekretin profesional. Ai nuk mund të transmetojë informacionet që i është besuar.

Ditën e regjistrimit të fëmijës tim në shkollën e tij, do të më jepet emri i qendrës PMS me të cilin shkolla është lidhur.

Unë mund të kërkoj të takoj Qendrën PMS që punon me shkollën e fëmijës tim. Kjo është falas.



Kujt t'i drejtohem në qoftë se ne takojmë vështirësi të tjera në shkollë ?


Në disa qytete, në qoftë se unë has probleme komunikimi me personelin e shkollës, mund t'u kërkoj ndihmë mediatorëve dhe mediatorëve ndërkulturore. Ata kërkojnë të vendosin një dialog me shkollën. Ata mundën të më ndihmojnë për të komunikuar dhe afruar me personelin e shkollës.

Në qoftë se fëmija im është viktimë e racizmit ose dëshmitar të akteve raciste, unë duhet të reagoj. Së pari, unë duhet të lajmëroj për së pari aktorët të vijës së parë të shkolles. Gjithashtu mund të lajmëroj CPMS të shkolles që mund të realizojnë aktivitete mbi interkulturalizmin në klasë. Pastaj, shërbimet e specializuara të të Drejtave të Njërit mund të na këshillojnë dhe të na shoqërojnë. Qendra për Barazimin e Shanëve dhe të luftës kundër Racizmit është aty për të pritur dhe trajtuar ankesat e depozituara për racizëm dhe diskriminim.

<http://www.diversite.be>

Një numër falas është në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit e detyruar për të informuar prindërit e xënësve që janë dëshmitar ose viktimë e dhunës në shkolle.

Ecole et Parents
0800/95 580
numéro gratuit d'information
ouvert du lundi au vendredi de 9h à 18h



Çfarë duhet të bëj në rast transferimi ?

Duhet të lajmëroj Drejtorinë e shkollës për datën në të cilën fëmija im do të largohet nga shkolla. Në qoftë se është e mundur, duhet të transmetoj adresën e shkollës së re të fëmijës tim.

Në qoftë se fëmija im është në shkollën fillore: një dokument do të më jepet nga shkolla nga ku fëmija

im po largohet. Ky dokument i plotësuar do t'i jepet shkollës së re të fëmijës tim.

Në shkollën e mesme, Drejtoria e shkollës së re të fëmijës tim do të marrë kontakt me Drejtorinë e shkollës së mëparshme për të siguruar ndjekjen e dosjes.



Ku mund të mësoj frëngjishten ?

Në disa qendra për kërkues azili të Kryqit të Kuq të Belgjikës, jepen kurse të gjuhës frënge.

<http://www.guidesocial.be/>

Në shumë qytete ekzistojnë shoqata që propozojnë kurse për të mësuar frëngjisht. Të dhëna të këtyre shoqatave mund t'i konsultoni veçanërisht në sitën e udhëzuesit social.

Ku mund të gjej informacione të tjera?

Sita interneti :

www.enseignement.be (lista e shkollave që kanë një **DASPA**, lista e qendrave PMS të lidhura me shkolla, shpjegime programesh dhe shpjegime të niveleve të ndryshëm shkollorë, regjistrimet...)
www.devenirKLK1.be (zgjedhje formacionesh)
www.orientation.be (orientime)
www.siep.be (orientime dhe zgjedhje formacionesh)
www.aidealajeunesse.cfwb.be >> rubrika shërbimeve të miratuara (lista e AMOve Pritje në Mjedis të hapur)
www.cire.be (shërbim përkthimi e kurse frëngjishte...)
www.ffedd.be (shkolla e **detyrave**)
www.guidesocial.be (sitë e përgjithshme që përmban adresat dhe numrat e telefonit të shoqatave që propozojnë shërbime lidhur me edukimin, orientimin, formacione, rivënie në nivelin shkollor...)
www.diversite.be (Qendra për barazimin e shanseve dhe të luftës kundër racizmit)

Numër telefoni :

Numër falas: Shkollë dhe prindërit: **0800/95 580**.
 Permanence dite Hënë deri të Premte nga ora 9.00 deri në 13.00.
 Ky numër përgjigjet pyetjeve lidhur me dhunen vetëm në mjedis shkollorë.
 Numër falas : **0800/188055**. Shërbimi ndihmës për regjistrime

Adresa :

SISP: Shërbimi i Informacionit mbi Studimet dhe Profesionet

Bruxelles :	109-111 rue de la Poste, 1030 Bruxelles	• 02/640.08.32
Charleroi :	51 boulevard P. Janson, 6000 Charleroi	• 071/33.12.06
Libramont :	39A grand rue, 6800 Libramont-Chevigny	• 061/21.32.21
Liège :	26 rue Saint Gilles, 4000 Liège	• 04/223.80.80
Mons :	101 chaussée de Binche, bloc C, 7000 Mons	• 065/33.48.22
Namur :	12 rue de Saintraint, 5000 Namur	• 081/25.14.00
Wavre :	13 rue de Flandre, 1300 Wavre	• 010/47.10.80



Fjalori

.....

Shoqata e prindërve :	Group prindërisht të nxënësve që kërkojnë të bashkëpunojnë me personelin e shkollës për të përmirësuar mirëqënien e nxënësve. Ata janë urë lidhëse midis personelit të shkollës dhe prindërve të nxënësve.
Klasa-kalimtare :	Klasë që ka për objektiv rivënien në nivel të nxënësve të sapo ardhur, gjithashtu mësimin intensiv të frëngjishtes.
Këshilli i Integritimit :	Është i përbërë nga mësues të ciklit që i korrespondon moshës së nxënësit dhe drejtohet nga Drejtoria e shkollës. Ai ka për objektiv integrimin e nxënësve të klasave-kalimtare në klasat të zakonshme në funksion të nivelit të tyre.
Kurs morali :	Kurs që synon t'u mësojë nxënësve të drejtat dhe detyrat qytetare, bazat e demokracisë, lirisë, komunikimit, për të zhvilluar shpirtin kritik.
Detyrat :	Punë me shkrim, ushtrime, të mësuarit që nxënësit duhet të bëjnë jashtë orëve të kursit. Ato janë dhënë nga mësuesi.
Diplomë :	Dokument që provon kalimin me sukses të një provimi .
Shkollat e lira :	Arsimi në to është organizuar nga organizma fetarë ose shoqata.
Shkollat zyrtare :	Arsimi është organizuar nga pushteti publik.
Nxënës i lirë :	Nxënës që nuk mund të kalojë provimet dhe të pretendojë në kalimin e vitit pasardhës.
Provime :	Teste me shkrim ose me gojë që vlerësojnë kompetencat e nxënësve.
Ditari i klasës :	Fletore, ditar ose bllok shënimesh që i lejon nxënësit të shkruajë oraret e kurseve, detyrat (ushtrimet dhe mësimet) që janë për t'u bërë në shtëpi. Ai i jep mundësinë prindërve dhe mësuesve të komunikojnë me shkrim.
Të justifikosh mungesën e tij :	Të sjellësh një dokument në administratën e shkollës që shpjegon arsyet e mungesës së fëmijës tuaj. (Per shembull : çertifikatë e dhënë nga Mjeku).
Rregullore e Urdhërit të Brëndshëm (fr. ROI) :	Dokument i dhënë prindërve gjatë regjistrimit të nxënësit që prezanton rregullat e ndryshme të jetës që janë për t'u respektuar në shkollë. ROI-i prezanton edhe sanksionet e mundshme në rast se nuk respektohen këto rregulla.

Lista e diplomave të dhëna

Vërtetimet (shkolla fillore dhe e mesme)

Nxënësit marrin një vërtetim (**diplomë**) për çdo « moment kyç » të ecursë së tyre shkollore :

- C.E.B.** [Çertifikatë e Studimeve të Bazës] : fund i shkollës fillore
- C.2.D.** [Çertifikatë e studimeve të mesme të Gradës së Dytë] : fund i vitit të katërt të së mesmes
- C.E.S.S.** [Çertifikatë e Studimeve të Mesme Superiore] : fund i vitit të gjashtë të shkollës së mesme (kjo certifikatë jep mundësinë për të ndjekur shkollën e lartë)
- C.Q.6** [Çertifikatë Kualifikimi 6] : fund i vitit të gjashtë të shkollës së mesme të kualifikimit
- C.Q.7** [Çertifikatë Kualifikimi 7] : fund i vitit të shtatë të shkollës së mesme të kualifikimit
- C.P.6** [Çertifikatë studimesh të vitit të Gjashtë të shkollës Profesionale] : fund i vitit të gjashtë të studimeve profesionale

Vërtetimet (në shkollën e mesme)

Gjatë « gradës së dytë » (vitet e treta dhe të katërta) dhe « gradës së tretë » (vitet e pesta dhe të gjashta) të shkollës së mesme, drejtoritë japin një nga « vërtetimet » e poshtëshënuara në fund të çdo viti shkolle :

- AOA** [Vërtetim Orientimi A] : sukses i plotë (nxënësi kalon klasën dhe mund të zgjedhë tipin e shkollës, formën dhe opsionin për vitin që vjen)
- AOB** [Vërtetim Orientimi B] : sukses me kufizim (nxënësi mund të kalojë klasën por zgjedhja e tij do të jetë e kushtëzuar nga kufizimi i vënë nga profesorët në dhënien e vendimit në fund të vitit shkolle)
- AOC** [Vërtetim Orientimi C] : mbetje në klasë (përsëritje e vitit e detyruar).

Merci et bravo
à nos illustrateurs !

